

RAPORT

MENAXHIMI I MBETURINAVE NË KOSOVË

Këndvështrimi i qytetarëve lidhur me menaxhimin e mbeturinave

SHKURT 2022

Përkrahur nga:



REPUBLIKA E KOSOVËS - PRESIDENTJA
REPUBLIC OF KOSOVO - THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO - PRESDENICA

RAPORT - MENAXHIMI I MBETURINAVE NË KOSOVË

Këndvështrimi i qytetarëve lidhur me menaxhimin e mbeturinave

Publikuar nga: Center for Education and Development of Environment (CEDE)

Autor: Tahir Krasniqi

Kontribuues: Arben Nika

Programi: Qeverisje e Mirë

Data e publikimit: Shkurt 2022

Dizajni: Krenar Nika

Adresa: Rr. "Bedri Shala", Veranda II – kati II, 13000, Drenas.

Kontakti: ojqcede@gmail.com
+383 49 97 87 01; +383 49 97 87 02; +383 49 97 87 03
www.cede-ks.org

Deklaratë mohimi:



Ky raport, është publikim i organizatës Qendra për Edukim dhe Zhvillim Mjedisor, në kuadër të projektit "Qeverisje e Mirë – Mjedis i Pastër!" nga programi Qeverisje e Mirë. Fragmentet e këtij raporti nuk mund të ripërdoren, të ruhen ose të transmetohen, në asnjë formë apo mënyrë, pa miratimin e botuesit. Publikimi mund të shpërmdahet në formë elektronike, si tërësi dhe jo për qëllime përfitimë.



REPUBLIKA E KOSOVËS - PRESIDENTIA
REPUBLIC OF KOSOVO - THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO - PREZIDENCA

Raporti është publikuar me mbështetjen nga Zyra e Presidencës së Republikës së Kosovës. Pikëpamjet e autorit të shprehura në këtë publikim nuk i pasqyrojnë pikëpamjet dhe qëndrimet e Zyrës së Presidencës së Republikës së Kosovës.

TABELA E PËRMBAJTJES

TABELA E PËRMBAJTJES	3
PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE	4
HYRJE.....	5
Konteksti i menaxhimit të mbeturinave në Kosovë.....	5
METODOLOGJIA	6
TË GJETURAT	7
SISTEMI I MENAXHIMIT TË MBETURINAVE NË KOSOVË.....	8
Korniza legjislative	8
Plani Komunal i Menaxhimit të Mbeturinave - PKMM	9
Rregullorja Komunale e Menaxhimit të Mbeturinave - RRKMM.....	11
Mbulueshmëria me shërbim.....	16
Deponitë ilegale	18
KËNDVËSHTRIMI I QYTETARËVE PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE.....	20
PËRFUNDIMET.....	29
REKOMANDIMET.....	30
BURIMET	30

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Mbeturinat janë një prej ndotësve kryesorë të mjedisit në të cilin jetojmë. Ato krijohen nga aktiviteti ditor i individëve, familjeve, bizneseve dhe gjeneruesve të ndryshëm. Menaxhimi jo-adekuat i mbeturinave shkakton rreziqe serioze për shëndetin e njeriut, mjedisin dhe jetesën në përgjithësi. Për të eliminuar këto rreziqe, është e nevojshme të krijohen sisteme për menaxhimin e mbeturinave. Kjo përfshin proceset dhe veprimet e nevojshme për të menaxhuar mbeturinat që nga momenti i krijimit të tyre deri në asgjësimin përfundimtar.

Në Kosovë, pak flitet publikisht lidhur me mbeturinat e sistemet për menaxhimin e tyre. Ndërsa, në Raportin e Progresit për Kosovën, tash e tre vite vazhdon të përsëritet se menaxhimi i mbeturinave në Kosovë është një prej sektorëve mjedisor i cili vazhdon të mbetet i paqëndrueshëm. Ekziston mbulueshmëri e ultë e grumbullimit të mbeturinave, ka shumë deponi ilegale, nuk ofrohen skema të ndarjes në burim si dhe mungon futja e masave të ekonomisë qarkore.

Ky raport, është hartuar me qëllim të hulumtimit të gjendjes aktuale të menaxhimit të mbeturinave komunale në Kosovë nëpërmjet prezantimit të disa prej treguesve kryesor të këtij sektori, që përfshinë zbatimin e legjislacionit, mbulueshmërinë me shërbim, deponitë ilegale, si dhe në anën tjetër, nëpërmjet paraqitjes së këndvështrimit të qytetarëve lidhur me cilësinë e menaxhimit të mbeturinave, për të cilin është zhvilluar një pyetësor.

Gjetjet tregojnë se nuk ekziston plan nacional për menaxhim të mbeturinave. 87% e komunave kanë hartuar planet komunale të menaxhimit të mbeturinave, por janë 20 komuna të cilat aktualisht nuk kanë periudhë të vlefshme të zbatimit, që nënkupton se këto komuna menaxhojnë mbeturinat pa bazë planifikimi. Në terren, vetëm në vitin 2021, janë identifikuar gjithsej 1188 deponi ilegale, ku prej tyre 558 janë të mëdha – gjendje e cila vazhdon të mbetet problematike. Përrjashtimisht nga viti i fundit, sasia e mbeturinave që deponohet në deponitë qendrore është në rritje. E në anën tjetër, vetëm rreth 5% e ekonomive familjare kanë qasje në infrastrukturë për ndarje të mbeturinave në burim. Por, nuk ka sistem të përcaktuar mirë të grumbullimit të ndarë të mbeturinave, riciklimit apo nisma në ekonomisë qarkore.

Në përgjigjet e qytetarëve në pyetësor, ndër të tjera rezulton se në shërbimin aktual të menaxhimit të mbeturinave, për 47.5% të respondentëve, mbeturinat përreth shportave, janë problemi që i pengon më së shumti. 77.5% e tyre mendojnë se autoritetet kompetente nuk po punojnë mjaftueshëm për menaxhimin e mbeturinave dhe 97.1% e respondentëve deklarohen se nëse ndarja e mbeturinave në burim kërkohet nga ta, do ta bëjnë atë.

Disa nga veprimet që duhen të merren nga akterët e sistemit të menaxhimit të mbeturinave është të vazhdohet rritja e shkallës së mbulueshmërisë me shërbime bazike në 100% në mënyrë që të adresohet gjendja me deponitë ilegale. Plani i republikës së Kosovës, dhe planet e reja komunale të menaxhimit të mbeturinave të orientohen në ekonominë qarkore – në reduktim, ndarje në burim, ripërdorim e riciklim, në mënyrë që të zvogëlohet sasia e mbeturinave që deponohet në deponitë qendrore.

Konteksti i menaxhimit të mbeturinave në Kosovë

Shtimi i popullsisë dhe aktiviteti njerëzor, me zhvillimin e ekonomisë, krijon çdoherë e më shumë mbeturina. Kjo krijon nevojën për reduktimin e tyre, në mënyrë që të mos kemi mjedis të ndotur. Reduktimi / zvogëlimi i sasisë së mbeturinave kërkon një sistem efikas të menaxhimit të tyre. Ky sistem, për menaxhimin e mbeturinave është mjaft kompleks dhe kërkon bashkëpunim shumë-sektorial. Sistemi jo-adekuat i menaxhimit të mbeturinave shkakton rreziqe serioze në shëndetin e njeriut, në mjedis dhe në jetesën në përgjithësi.

Sistemet e menaxhimit të mbeturinave dizajnohen për të ruajtur mjedisin dhe për të përmirësuar gjendjen e jetesës.

Në Kosovë, sipas Ligjit mbi Mbeturinën, përmes Nenit 15, menaxhimi i mbeturinave është kompetencë e komunave, nëpërmjet zhvillimit të mekanizmave të planifikimit lokal, krijimit të sistemit të nevojshëm dhe sigurimit të zbatimit të tyre përmes departamenteve të shërbimeve publike dhe inspektorateve komunale.

Sipas palëve brenda sistemit, në vitet e fundit vazhdon të theksohet se menaxhimi i mbeturinave është i qëndrueshëm, është arritur progres i madh si dhe mjedisi nuk është i ndotur nga mbeturinat. Megjithatë, në Raportin e Progresit për Kosovën, tash e tre vite vazhdon të përsëritet se menaxhimi i mbeturinave në Kosovë është një prej sektorëve mjedisor i cili vazhdon të mbetet i paqëndrueshëm. Ekziston mbulueshmëri e ultë e grumbullimit të mbeturinave, ka shumë deponi ilegale, nuk ofrohen skema të ndarjes në burim si dhe mungon futja e masave të ekonomisë qarkore.

Qëllimi i këtij raporti është të hulumtojë mbi gjendjen e menaxhimit të mbeturinave komunale në Kosovë, të prezantojë shkurt dhe qartë treguesit kryesorë të gjendjes aktuale si dhe të paraqesë këndvështrimin e qytetarëve lidhur me menaxhimin e mbeturinave. Me këtë raport, CEDE synon të nxisë debat mbi këtë sektor dhe të kontribuojë në krijimin e politikave më efikase dhe të qëndrueshme të sektorit të menaxhimit të mbeturinave në Kosovë.

Ky hulumtim, është zhvilluar në kuadër të projektit “Qeverisje e Mirë – Mjedis i Pastër!” nga programi Qeverisje e Mirë, dhe mbështetur nga Zyra e Presidencës së Republikës së Kosovës.

METODOLOGJIA

Për të paraqitur gjendjen e menaxhimit të mbeturinave, janë përdorur metoda cilësore të kërkimit, duke përfshirë kërkimet dytësore – në tavolinë, si dhe kërkimet parësore nëpërmjet zhvillimit të një pyetësi online për të identifikuar kënaqshmërinë dhe këndvështrimin e qytetarëve lidhur me shërbimin e grumbullimit të mbeturinave.

Është përzgjedhur hulumtimi nëpërmjet metodës së kërkimeve në tavolinë, për të mundësuar përmbledhjen dhe paraqitjen e gjendjes aktuale dhe trendeve të menaxhimit të mbeturinave në Kosovë. Për këtë, janë analizuar të dhëna nga burimeve të ndryshme. Pasqyrimi i sistemit dhe gjendjes aktuale të menaxhimit të mbeturinave është paraqitur nëpërmjet disa prej treguesve kryesor të këtij sektori, që përfshinë zbatimin e legjislacionit, mbulueshmërinë me shërbim, deponitë ilegale, etj. Për këtë, janë shqyrtuar raporte të ndryshme nga institucione dhe organizata vendore e ndërkombëtare lidhur me menaxhimin e mbeturinave.

Në anën tjetër, është zhvilluar një pyetësor për të mundësuar paraqitjen e këndvështrimit të qytetarëve lidhur me cilësinë e menaxhimit të mbeturinave. Ky pyetësor ka qenë i fokusuar në mbledhjen e të dhënave demografike për respondentët, mbi perceptimin e tyre mbi mjedisin në përgjithësi, dhe specifikisht, mbi përshtypjen e tyre mbi shërbimin e grumbullimit të mbeturinave në vendbanimin e tyre.

Pyetësori është shpërndarë online në formë të sponsorizuar, në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës. Është mundësuar grumbullimi i të dhënave nga 500 respondentë, prej tyre 52.5% nga gjinia mashkullore, 46.8% nga gjinia femërore, kurse nuk janë deklaruar 0.7% e tyre. Sipas vendbanimit, 64.4% e tyre janë banorë në zonat urbane / qytet, kurse 35.6% në zonat rurale. Hulumtimi nëpërmjet këtij pyetësi është zhvilluar nga data 13 dhjetor 2021 deri më 20 janar 2022. Të dhënat janë analizuar nëpërmjet Excel-it, kurse janë ilustruar nëpërmjet grafikëve dhe formave tabelave.

TË GJETURAT

Mbetjet / mbeturinat janë materiale të padëshiruara ose të papërdorshme. Ato krijohen nga shtëpitë tona, bizneset, industria, vendet e ndërtimit, spitalet dhe gjenerues të ndryshëm. Gjërat që i hedhim duhet të ruhen, mblidhen, transportohen, përpunohen, riciklohen, trajtohen dhe të deponohen në mënyrë të sigurt.

Sipas Ligjit në Kosovë, definicioni mbi mbeturinat paraqitet si më poshtë:

Mbeturinat janë substancë apo objekt që prodhuesi apo zotëruesi e hedh, ka për qëllim ta hedh apo është i detyruar t'a hedhë.

Megjithëse kjo paraqet një term të përgjithshëm, mbeturinat mund të klasifikohen për nga burimi i gjenerimit të tyre. Sipas kësaj, Ligji për mbeturinat, i ndanë mbeturinat në 4 lloje/grupe kryesore:

MBETURINAT KOMUNALE

Mbeturinat komunale përfshijnë mbeturinat nga amvisëritë, dhe mbeturinat nga aktivitetet tjera të cilat për shkak të përbërjes dhe natyrës së tyre, janë të ngjashme me ato të amvisërisë;

MBETURINAT KOMERCIALE

Mbeturinat komerciale janë mbeturinat të cilat vijnë nga objektet që përdoren për qëllimet e tregut ose biznesit, sportit, edukimit, rekreacionit, por nuk përfshihen mbeturinat industriale;

MBETURINAT INDUSTRIALE

Mbeturinat Industriale janë mbeturinat të cilat krijohen nga aktivitetet, proceset industriale, prodhimi artizanale dhe veprimtari tjera prodhuese;

MBETURINAT MEDICINALE

Mbeturinat medicinale përfshijnë mbeturinat të cilat krijohen gjatë kryerjes së shërbimeve medicinale;

Edhe pse të ndara në grupe, këto kategori në praktikë gjenerojnë mbeturina të cilat për nga forma mund të jenë të njëjta ose të ngjashme. Andaj, bazuar në këtë faktor, mbeturinat nga kategoritë e mësipërme përmbledhen në një term të përgjithshëm si 'mbeturina të ngurta komunale'.

Siç u tha edhe më sipër, përgjegjës për krijimin e sistemit të menaxhimit të mbeturinave të ngurta në Kosovë, sipas Ligjit, janë komunat. Këto sisteme dizajnohen për të ruajtur mjedisin dhe për të përmirësuar gjendjen e jetesës nëpër komuna. Sistemi jo-adekuat i menaxhimit të mbeturinave ndikon negativisht në jetën e qytetarëve lidhur me shëndetin e tyre, mjedisin si dhe socio-ekonominë.

Por, si janë të krijuara sistemet për menaxhimin e mbeturinave në Kosovë?

SISTEMI I MENAXHIMIT TË MBETURINAVE NË KOSOVË

Korniza legjislative

Në Kosovë, menaxhimi i mbeturinave rregullohet nëpërmjet Ligjit nr. 04/L-060 për Mbeturinat, miratuar në vitin 2012. Qëllimi i këtij Ligji është evitimi dhe reduktimi sa më i madh i mundshëm i gjenerimit të mbeturinave; ripërdorimi i komponentëve të përdorshëm nga mbeturinat; zhvillimi i qëndrueshëm përmes mbrojtjes dhe ruajtjes së resurseve natyrore; parandalimi i ndikimeve negative të mbeturinave në mjedis dhe shëndetin e njeriut; dhe deponimi përfundimtar i mbeturinave në mënyrë të pranueshme mjedisore. Menaxhimi i mbeturinave, gjithashtu, rregullohet edhe nëpërmjet akteve tjera nënligjore, të nxjerra nga ministria.



Sipas Ligjit, dokumentet kryesore për planifikim dhe menaxhim të mbeturinave janë:

1. Strategjia e Republikës së Kosovës për menaxhimin e mbeturinave;
2. Plani i Republikës së Kosovës për menaxhimin e mbeturinave;
3. Plani Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave; dhe
4. Planet për menaxhimin e mbeturinave nga zotëruesit e mbeturinave dhe Planet për menaxhimin e mbeturinave nga personat e licencuar.

Strategjia paraqet dokumentin kryesor strategjik lidhur me menaxhimin e mbeturinave. Ajo hartohet nga ministria, me periudhë zbatimi prej 10 vitesh dhe miratohet nga qeveria. Strategjia duhet të jetë e mbështetur në ligjin për mbeturinat dhe në parimet e cekura në Ligj.

Fig. 1. Dokumentet për planifikim dhe menaxhim të mbeturinave

Planin e Republikës së Kosovës gjithashtu e harton ministria, i cili duhet të jetë në harmoni me Strategjinë dhe të ketë periudhë kohore prej 5 vitesh.

Në anën tjetër, plani komunal i menaxhimit të mbeturinave hartohet nga komuna, me periudhë zbatimi prej 5 vitesh. Ky Plan duhet të jetë në harmoni me Planin e Republikës së Kosovës për menaxhimin e mbeturinave.

2 dokumentet e fundit duhet të jenë në harmoni me planin komunal të menaxhimit të mbeturinave, përderisa nuk menaxhohet me mbeturina të rrezikshme, përndryshe, ato duhet të jenë në harmoni me Planin e Republikës së Kosovës për menaxhimin e mbeturinave.

Derisa dy dokumentet e para japin kornizën e menaxhimit të mbeturinave në nivel nacional, plani komunal i menaxhimit të mbeturinave duhet të japë objektiva dhe aktivitete konkrete që organizojnë shërbimin dhe ndikojnë drejtpërdrejtë në jetën e qytetarëve brenda një komune.


1. Ekziston bazë e mjaftueshme ligjore e cila rregullon kornizën planifikuese të menaxhimit të mbeturinave në nivel vendi.
2. Strategjia e republikës së Kosovës për menaxhimin e mbeturinave është miratuar në vitin 2021, me periudhë zbatimi 2021-2030 dhe me plan të veprimit me periudhë 2021-2023.
3. Nuk ka plan të Republikës së Kosovës për menaxhimin e mbeturinave, me periudhë të vlefshme zbatimi.

Plani Komunal i Menaxhimit të Mbeturinave - PKMM

Prej komunave, kërkohet që të kenë Plan Komunal të Menaxhimit të Mbeturinave. Ky Plan paraqet dokumentin themelor me të cilin organizohet procesi i menaxhimit të mbeturinave në nivel të komunës. Qëllimi i tij është ofrimi i kornizës strategjike për menaxhimin e qëndrueshëm të mbeturinave për territorin e administruar nga komuna në pajtueshmëri me dispozitat ligjore dhe kornizën planifikuese strategjike.

Ndër elementet kryesore që duhet të ketë ky Plan përfshijnë qëllimet që synohen të arrihen për reduktimin, ripërdorimin, trajtimin ose riciklimin e mbeturinave në territorin e përfshirë sipas planit; programin për mbledhjen, grumbullimin dhe ndarjen e mbeturinave; propozimet për teknikat e mundshme për ripërdorimin dhe riciklimin e komponentëve të ndryshme nga mbeturinat komunale; programet për ngritjen e vetëdijesimit dhe arsimimit të publikut, lidhur me menaxhimin e mbeturinave; etj. Sipas Ligjit, sipas nevojës dhe në marrëveshje, dy a më shumë komuna mund të nxjerrin planin e përbashkët lokal për menaxhimin e mbeturinave. Këtë mundësi, asnjë prej komunave në Kosovë nuk e ka përdorur.


Planet Komunale të Menaxhimit të Mbeturinave, komunat kanë filluar t'i hartojnë qysh nga viti 2014. Gjendja e tyre, me vitin e përfundimit të zbatimit, është paraqitur në grafikun e mëposhtëm:



Grafiku 1: Komunat që kanë Plan Komunal të Menaxhimit të Mbeturinave dhe viti i përfundimit të tyre

Bazuar në të dhënat e Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit në Kosovë (AMMK), deri në vitin 2020, 33 komuna kanë të hartuar Planin Komunal të Menaxhimit të Mbeturinave, ndërsa 5 komuna nuk kanë të hartuar këtë Plan. Megjithatë, prej kohës së miratimit të Ligjit ka kaluar një dekadë, këto Plane për disa komuna kanë përfunduar periudhën e zbatimit të tyre e disa janë ende në zbatim.

Duke pasur parasysh gjendjen e menaxhimit të mbeturinave para 5 vitesh, Planet e kaluara të të gjitha komunave kanë qenë të fokusuara kryesisht në krijimin e sistemit dhe ofrimin e shërbimeve bazike të grumbullimit të mbeturinave. Objektivat më të shprehura nëpër Plane kanë qenë ndërtimi i kapaciteteve njerëzore dhe institucionale, shtrirja e ofrimit të shërbimit të grumbullimit të mbeturinave për të gjithë banorët e tyre si dhe aktivitete vetëdijesimi. Për ofrimin e shërbimeve bazike të mbledhjes së mbeturinave, është arritur progres, sidomos në 4 vitet e fundit, ku përqindja e mbulueshmërisë nga 70% ka arritur në 85% të ekonomive familjare. Megjithëse nëpër këto Plane janë paraqitur edhe objektiva e veprime për ndarje dhe riciklim të mbeturinave, në terren kjo nuk është realizuar, ose janë realizuar pa rezultate të theksuara në zvogëlim të mbeturinave që deponohen në deponi qendrore. Lidhur me këtë, vetëm rreth 5% e ekonomive familjare në nivel vendi, kanë qasje në infrastrukturë të ndarjes së mbeturinave në burim.



Grafiku 2. Numri i komunave dhe periudha e zbatimit të Planeve Komunale të Menaxhimit të Mbeturinave

Me përfundimin e periudhës së zbatimit, nga komunat kërkohet të kenë Plan për periudhën e ardhshme 5 vjeçare. Ato duhet të vlerësojnë progresin e arritur nga periudha paraprake, të skanojnë gjendjen e re aktuale të menaxhimit të mbeturinave në territorin e tyre dhe të hartojnë PKMM-të e reja për të ardhmen.

Edhe pse aktualisht janë 20 komuna të cilat nuk kanë Plan me periudhë të vlefshme, ende nuk janë marrë iniciativa për hartimin e planit të ri komunal të menaxhimit të mbeturinave. Në anën tjetër janë 6 komuna të cilave iu përfundon periudha e zbatimit në vitin 2022, dhe duhet të hartojnë Planin për periudhën e ardhshme.

Për nivelin e arritur të objektivave, rezultateve apo aktiviteteve të Planit Komunal të Menaxhimit të Mbeturinave të komunave nuk ka ndonjë vlerësim apo raport nga vetë komunat apo organizata të ndryshme joqeveritare.


1. Ekzistojnë 20 komuna që nuk kanë plan komunal të menaxhimit të mbeturinave me periudhë të vlefshme të zbatimit.
2. 6 komuna kanë plan komunal të menaxhimit të mbeturinave, periudha e të cilëve përfundon në vitin 2022.
3. Nuk ekzistojnë raporte mbi vlerësimin e efekteve dhe të nivelit të zbatueshmërisë së planeve komunale të menaxhimit të mbeturinave.

Rregullorja Komunale e Menaxhimit të Mbeturinave - RRRKMM

Tjetër kërkesë nga Ligji për Mbeturinat (neni 15 dhe 34) dhe nga Ligji për Vetëqeverisjen Lokale (neni 12, 17 dhe 40) është që komunat të rregullojnë ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike, përgjegjësitë dhe detyrimet për kryerjen e shërbimeve, rregullat dhe kushtet për menaxhimin e mbeturinave. Këto, në komunat e Republikës së Kosovës, rregullohen nëpërmjet hartimit të Rregullores Komunale për Menaxhimin e Mbeturinave. Qëllimi i këtyre rregulloreve është që të rregullojë sistemin dhe kushtet për mënyrën e mbledhjes, ndarjes, përpunimit dhe riciklimit të mbeturinave, orarin e shërbimit, numrin dhe mënyrën e shpërndarjes dhe vendosjes së kontejnerëve, caktimin e tarifës dhe mënyrës së inkasimit, mirëmbajtjen e vendeve ku grumbullohen mbeturinat dhe mënyrën e transportimit.

Për dallim nga PKMM, rregulloret nuk kanë ndonjë afat të përcaktuar kur duhet të ndryshohen. Megjithatë, ndryshimet e ndodhura në sistemin e menaxhimit të mbeturinave, duhet të reflektohen edhe në Rregullore.

Në grafikun e mëposhtëm, janë të paraqitura komunat të cilat kanë të hartuar këtë rregullore, si dhe vitin kur ato kanë miratuar këtë rregullore.



Grafiku 3: Komunat që kanë Rregullore Komunale të Menaxhimit të Mbeturinave dhe viti i miratimit të tyre

Në Kosovë, 27 komuna kanë të hartuar këto lloje të rregulloreve. Megjithatë, edhe pse është kërkesë ligjore, mbetin 11 komuna të cilat aktualisht nuk kanë të hartuar Rregulloren Komunale të Menaxhimit të Mbeturinave.

Bazuar në këto dy dokumente të organizimit (Plan dhe Rregullore) të menaxhimit të mbeturinave në nivel lokal, ndër të tjera, komunat përzgjedhin operatorët që ofrojnë shërbim, përcaktojnë tarifën e shërbimit, paraqesin qëllimet dhe objektivat lidhur me reduktimin, ripërdorimin, trajtimin ose riciklimin e mbeturinave në territoret e tyre.

Tarifat e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave janë vlerë për të cilat ekonomitë familjare paguajnë për ofruesit e shërbimit, të cilat rregullohen brenda Rregulloreve. Nëpër disa komuna, ekonomitë familjare tarifën e shërbimit e paguajnë direkt tek ofruesit e shërbimit (operatorët ekonomik) e disa direkt në komuna (në komunat që kanë inkasimin brenda komunës). Kjo tarifë duhet të përcaktohet në bazë të kostove operative të ofruesve të shërbimit, duke kaluar nëpër një proces të detajuar të kalkulimit të kostove, që reflekton arsyeshmërinë se pse ekonomitë familjare paguajnë shumë më pak se paguajnë. Sipas AMMK-së, 22 komuna kanë caktuar tarifën duke kaluar nëpër procesin e kalkulimit të kostove.

Në anën tjetër, në Kosovë, mbeturinat grumbullohen nëpërmjet operatorëve publikë, privat, në bazë të marrëveshjeve të partneritetit publiko-privat, apo edhe nëpërmjet kombinimit të këtyre opsioneve. Më të shprehur, janë operatorët që ofrojnë shërbimin në kuadër të një rajoni ose Kompani Rajonale të Mbeturinave (KRM). Për të ushtruar veprimtarinë, secili operator duhet të jetë i licencuar për menaxhimin e mbeturinave, pranë ministrisë përkatëse. Për përzgjedhjen e operatorit për ofrimin e shërbimit për mbeturinat, komunat janë të lira të përzgjedhin dhe veprojnë sipas objektivave të tyre. Operatorët që ofrojnë këto shërbime, ndarë sipas komunave të ndryshme në Kosovë, janë paraqitur në figurën e mëposhtme:




Fig. 2: Operatorët që ofrojnë shërbimet e menaxhimit të mbeturinave në Kosovë

Aktualisht ekzistojnë 15 operatorë të ndryshëm që ofrojnë shërbime të grumbullimit të mbeturinave në Kosovë. Në pjesën më të madhe të komunave të Kosovës mbeturinat grumbullohen nga kompani rajonale të mbeturinave (KRM), ndërsa grumbullimi i mbeturinave bëhet edhe nga ndërmarrje publike lokale (NPL), kompani private si dhe në disa komuna ofrohet shërbimi në kuadër të organizimit komunal.

Në komunën e Rahovecit grumbullimi i mbeturinave bëhet nga dy operatorë të ndryshëm, nga “Ekoregjioni”, i cili ofron shërbime në nivel rajonal, dhe nga “Eko Drinia” i cili është operator privat dhe ofron shërbim në disa vendbanime të komunës. Rast i njëjtë është edhe në komunën e Podujevës, ku ofrohet shërbim nga KRM “Pastrimi” në një pjesë, dhe në anën tjetër nga operatori privat “Natyra”.

Përveç këtyre operatorëve të paraqitur më sipër, ekzistojnë edhe nisma të vogla joformale ose nisma të reja formale të grumbullimit të mbeturinave të ndara, kryesisht në nivel të vogël veprimi.

3

1. Ekzistojnë 11 komuna që nuk kanë Rregullore Komunale të Menaxhimit të Mbeturinave, nuk kanë të publikuar në ueb faqen e tyre ose nuk kanë raportuar se kanë rregullore të tillë.
2. Ekzistojnë 15 operatorë të ndryshëm që ofrojnë shërbimin e grumbullimit të mbeturinave në territorin e Kosovës.

Mbeturinat e grumbulluara nga këta operatorë transportohen për deponim të përkohshëm nëpër transfer stacione ose direkt në deponitë qendrore për deponim të përhershëm. Arsyeja e ekzistencës së transfer stacioneve nëpër komuna është që të zvogëlohen kostot e transportit të mbeturinave direkt nga qytetarët në deponinë qendrore. Këtu, mbeturinat e grumbulluara nga ekonomitë familjare me kamionë grumbullues, deponohen në transfer stacion, e më pas me kamionë transportues, barten në deponinë qendrore rajonale. Transfer stacionet janë nën menaxhimin e komunave kurse deponitë qendrore menaxhohen nga Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë (KMDK). Shpërndarja e transfer stacioneve dhe e deponive qendrore është e paraqitur në figurën e mëposhtme:




Fig. 3: Deponitë dhe Transfer Stacionet në territorin e Kosovës

Aktualisht ekzistojnë 8 lokacione – deponi nëpër të cilat bëhet deponimi i përhershëm i mbeturinave. Ekzistojnë 3 transfer stacione, kurse planifikohet të ndërtohen edhe 5 transfer stacione tjera.

Sipas Strategjisë, Deponia e Pejës do të zgjerohet, ndërsa një deponi e re do të identifikohet për t'i shërbyer rajonit të Prishtinës. Deponitë e tjera rajonale synohet të avancohen, disa të vazhdojnë të funksionojnë ose të mbyllen dhe rehabilitohen. Për shkak të gjendjes jo të mirë, transfer stacionet aktuale në Ferizaj, Drenas dhe Gjakovë planifikohet të vihen në përputhje me standardet, ndërsa transfer stacione të reja pritet të ndërtohen në Istog, Klinë, Skenderaj dhe Novobërdë. Një transfer stacion tjetër është planifikuar të ndërtohet në Malishevë.

Në aspektin e operimit në terren, aktualisht, sistemi i grumbullimit të mbeturinave është paraqitur në figurën e mëposhtme:





Fig. 3: Sistemi aktual operativ i grumbullimit të mbeturinave në Kosovë

Skema paraqet formën bazike të funksionimit të zingjirit të grumbullimit të mbeturinave të ngurta komunale në Kosovë. Grumbullimi i mbeturinave bëhet nga gjeneruesit e mbeturinave nëpërmjet operatorëve që ofrojnë shërbimin, mbledhen nga ta dhe bëhet transportimi i tyre nëpër transfer stacione (në disa komuna) ose direkt për deponim të përhershëm në deponitë qendrore.

Përkundër disa nismave të vogla të inicimit të skemave të ndarjes në burim, mungojnë sisteme të grumbullimit të mbeturinave të ndara, të ripërdorimit apo riciklimit të komponentëve të ripërdorshëm dhe riciklueshëm.

Në anën tjetër, sasia e mbeturinave të deponuara përhershëm, është paraqitur në grafikun e mëposhtëm:




Grafiku 3: Sasia e mbeturinave të deponuara nëpër deponitë sanitare, shprehur në ton për vit

Trendi i rritjes së sasisë së mbeturinave të deponuara në deponitë sanitare është rritur në çdo vit. Përjashtim këtu bën viti 2020, ku sasia e deponuar në deponitë sanitare këtë vit është më e vogël në krahasim vitin paraprak.

Mbulueshmëria me shërbim

Një prej treguesve kryesorë të shërbimit të grumbullimit të mbeturinave është numri i klientëve të cilëve u ofrohet grumbullimi i mbeturinave – mbulueshmëria me shërbim. Kategoritë e klientëve nga të cilët bëhet grumbullimi i mbeturinave përfshijnë ekonomitë familjare, bizneset dhe institucionet. Në grafikun e mëposhtëm është paraqitur trendi i mbulueshmërisë së ekonomive familjare me shërbim të grumbullimit të mbeturinave.



Grafiku 4: Trendi i mbulueshmërisë së ekonomive familjare me shërbim të grumbullimit të mbeturinave

Sipas të dhënave, deri në dhjetor të vitit 2020, mbulueshmëria e ekonomive familjare është 85.3% në nivel vendi, Kjo përqindje është arritur si rezultat nga numri i ekonomive familjare të shërbyera në raport me numrin e ekonomive familjare nga regjistrimi i fundit i popullsisë nga Agjencioni i Statistikave të Kosovës në vitin 2011.

Nëse përqindja e mbulueshmërisë nxirret për secilën komunë në veçanti, ekzistojnë komuna të cilat kanë mbulueshmërinë mbi 100%. Teorikisht kjo nuk është e mundur, por vjen si rezultat migrimeve të brendshme dhe i mungesës së të dhënave të reja zyrtare mbi numrin e popullsisë dhe ekonomive familjare në Kosovë. Raste të tilla gjejmë kryesisht në komunat e mëdha, si Prishtinë, Prizren, Fushë Kosovë, etj., të cilat viteve të fundit janë përballur me fluks të madh të banorëve që ndërrojnë vendbanimin nga qytetet tjera.

Marrë parasysh këtë fakt, se nuk ka të dhëna të reja zyrtare, si dhe shtimin potencial të popullsisë, edhe përqindja e mbulueshmërisë, në masë të vogël, mund të ndryshojë.

Megjithatë, sipas këtyre të dhënave (zyrtare të vitit 2011), dhe të dhënave nga komunat për numrin e ekonomive familjare që kanë në shërbim, harta e mbulueshmërisë në Kosovë, ndarë për secilën komunë, duket si në figurën e mëposhtme:




Fig. 4: Harta e mbulueshmësisë me shërbim të grumbullimit të mbeturinave

Ekzistojnë disa komuna, Leposaviq, Zubon Potok, Shtërpçë, Klokot e Partesh, për të cilat nuk ka të dhëna me të cilat mund të paraqitet niveli i mbulueshmërisë së tyre. Kjo për shkak se këto komuna nuk raportojnë të dhëna mbi numrin e ekonomive familjare të cilave iu ofrohet ky shërbim.

Probleme për të dhëna, ngjashëm sikur tek ekonomitë familjare, ka edhe për mbulueshmërinë me shërbim për bizneset, porse përqindja e mbulueshmërisë paraqitet e ultë. Nëse merret për bazë numri i bizneseve të regjistruara sipas Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë (ARBK) mbulueshmëria e shërbimit del të jetë shumë e ultë, rreth 51% në nivel vendi. Por, ekzistojnë biznese të cilat nuk janë aktive, si pasojë e pushimit të veprimtarisë së tyre. Këto biznese realisht nuk gjenerojnë mbeturina, por figurojnë si biznese të regjistruara. Kjo ndikon në uljen e përqindjes së mbulueshmërisë me shërbim të grumbullimit të mbeturinave për bizneset.


4

1. Përqindja e mbulueshmërisë së ekonomive familjare me shërbim të grumbullimit të mbeturinave, në nivel vendi, deri në fund të vitit 2020, është 85.3%
2. Mungesa e të dhënave zyrtare mbi numrin e popullsisë dhe ekonomive familjare, jep të dhëna që nuk pasqyrojnë gjendjen reale në terren.

Deponitë ilegale

Tjetër tregues i rëndësishëm i gjendjes së menaxhimit të mbeturinave është edhe numri i deponive ilegale në territorin e një komune. Termi 'deponi ilegale' përkufizohet si çdo pikë jashtë deponive të përcaktuara në nenin 33 të Ligjit Nr. 04/60 për Mbeturina. Lidhur me këtë, Ligji për Mbeturina i obligon komunat që të nxjerrin një regjistër të deponive ilegale në territorin e tyre, brenda një periudhe njëvjeçare (Neni 81). Këtë duhet ta bëjnë inspektorët komunalë të mjedisit (neni 62).

Megjithëse niveli i mbulueshmërisë së grumbullimit të mbeturinave është mbi 80% e ekonomive familjare, në Kosovë vazhdojnë të identifikohen deponi ilegale – grumbuj të mbeturinave në hapësira publike. Vazhdohet të raportohet ndotje të parqeve, lumenjve e hapësirave publike. Lidhur me gjendjen e numrit të deponive ilegale, në vitin 2017 dhe në 2019 ne kemi zhvilluar një hulumtim mbi deponitë ilegale në nivel vendi. Të dhënat për vitet pasuese janë marrë nga AMMK. Trendi i sasisë së deponive ilegale është paraqitur në grafikun e mëposhtëm:



Grafiku 4. Trendi i numrit të deponive ilegale në Kosovë


Të dhënat në grafik janë rezultat i një identifikimi të bërë direkt në terren, duke vizituar çdo rrugë të çdo vendbanimi e çdo lagjeje.

Me rritjen e përqindjes së mbulueshmërisë, në 2 vitet e fundit, trendi i deponive ilegale është në rënie. Kjo për shkak të integritit të ekonomive familjare në shërbim.

Për nga kategorizimi i madhësisë, deponitë ilegale ndahen në 3 grupe:

- ≡ 'deponi e vogël' nënkupton sasi të mbeturinave 1-5 thasë të 200 litrave/ka nevojë për karrocë,
- ≡ 'deponi e mesme' nënkupton sasi të mbeturinave 5-20 thasë të 200 litrave/karroca dhe
- ≡ 'deponi e madhe', nënkupton sasi të mbeturinave mbi 20 karroca / nevojitet kamion.

Grafiku i mëposhtëm paraqet deponitë ilegale ndër vite, ndarë sipas kategorizimit të madhësisë:



Grafiku nr. 5: Deponitë ilegale në Kosovë, sipas madhësisë

Sipas kësaj grafike, deponitë ilegale të kategorisë 'të mëdha' janë më të shprehura në secilin vit kur është zhvilluar identifikimi i deponive ilegale. Megjithatë, Numri i tyre, në tre vitet e fundit, është në rënie.

5

1. Mungojnë sisteme të grumbullimit të mbeturinave të ndara, të ripërdorimit apo riciklimit të komponentëve të mbeturinave.
2. Aktualisht, ekzistojnë 1188 deponi ilegale në nivel vendi, 558 prej tyre janë të mëdha.

KËNDVËSHTRIMI I QYTETARËVE PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

Njëjtë sikurse shërbimet tjera komunale, ujësjellësi, kanalizimi apo edhe rryma, shërbimi i grumbullimit të mbeturinave nga këndvështrimi i qytetarëve konsiderohet të jetë i mirëqenë. Duhet të jetë aty, pa marrë parasysh sfidat dhe ngecjet që mund të jenë qoftë ligjore, planifikuese apo operative. Ata duan që mbeturinat që krijojnë, të mos mbesin në oborret apo pronat e tyre.


Në anën tjetër, askush nuk do që të jetojë në një mjedis i cili ia cenon shëndetin e tij. Të gjithë duan të jetojnë në një vend pa ndotje të tokës, ujit apo ajrit. Në këto tri elemente, faktor kontribuues në ndotje janë edhe mbeturinat. Në këtë aspekt, sistemi i paqëndrueshëm i menaxhimit të mbeturinave përkeqëson gjendjen. Andaj qytetarët kërkojnë shërbim të mirë të menaxhimit të mbeturinave, duan orar të rregullt të shërbimit, tarifa të përballeshme të shërbimit e infrastrukturë të mirë të menaxhimit të mbeturinave.

Për këtë, në kuadër të këtij hulumtimi është realizuar një anketë online, ku është shpërndarë në mënyrë të sponzorizuar në gjithë territorin e Republikës së Kosovës. Qëllimi i këtij pyetësi ka qenë identifikimi i problemeve me të cilat përballen qytetarët dhe vlerësimi i kënaqshmërisë së tyre lidhur me shërbimin e grumbullimit të mbeturinave.

Në këtë hulumtim, kanë marrë pjesë 500 respondentë, prej tyre 52.5% nga gjinia mashkullore, 46.8% nga gjinia femërore, kurse nuk janë deklaruar 0.7% e tyre. Sipas vendbanimit, 64.4% e tyre janë banorë në zonat urbane / qytet, kurse 35.6% në zonat rurale.


Disa nga pyetjet kryesore të anketës si dhe grafikat e përgjigjeve të tyre, janë paraqitur në vijim:

Cili nga problemet e mëposhtme mjedisore ju shqetëson më shumë?




Sipas pyetjes së mësipërme, 45% e qytetarëve më së shumti i shqetëson ndotja nga mbeturinat, pasuar me 28% të respondentve që shqetësohen nga ndotja e ajrit.

Sipas mendimit tuaj, a është problem mjedisor keq-menaxhimi i mbeturinave?




86% e respondentëve mendojnë se keq-menaxhimi i mbeturinave është një problem mjedisor. 17% mendojnë të kundërtën.

Sipas mendimit tuaj, cili opsion i më poshtëm është shqetësimi më i madh për ju që ndodhë nga mbeturinat?




43% e respondentëve shqetësim më të madh nga mbeturinat kanë efektet në shëndetin e njeriut. 41% shqetësohen për efektet në ndotjen e mjedisit, e 13% për shëmtimin e hapësirave publike.

Cila nga problemet e mëposhtme ju pengon më shumë në sistemin aktual të menaxhimit të mbeturinave?




47% e respondentëve, në sistemin aktual të menaxhimit të mbeturinave, më së shumti i pengojnë mbeturinat përreth shportave. 29% i pengojnë kafshët (qentë, minjtë, insektet) përreth shportave, e 15% i pengon era e pakëndshme.

A mendoni se autoritetet përgjegjëse po punojnë mjaftueshëm për menaxhimin e mbeturinave?




77.5% e respondentëve mendojnë se autoritetet përgjegjëse nuk po punojnë mjaftueshëm për menaxhimin e mbeturinave. 22.5% mendojnë të kundërtën.

A jeni të kënaqur me shërbimin aktual të grumbullimit të mbeturinave?




56.6% e respondentëve janë mesatarisht të kënaqur me shërbimin aktual të grumbullimit të mbeturinave. 30.9% janë shumë të kënaqur, ndërsa 12.5% janë aspak të kënaqur.

Sa shpesh ndodhin vonesat e grumbullimit të mbeturinave në vendbanimin tuaj?




30% e respondentëve janë deklaruar se vonesat për grumbullimin e mbeturinave ndodhin shumë rrallë. 23.1% thonë se nuk ndodhin vonesat. 21.6% thonë se ndodhin rrallë, 19.8% thonë se ndodhin shpesh, ndërsa 5.5% thonë se vonesat ndodhin shumë shpesh.

Çfarë mendoni për tarifën (çmimin) e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave?




81.7% e respondentëve mendojnë se tarifa e shërbimit është çmim mesatar – i përshtatshëm. 9.5% mendojnë se është çmim i lartë – i papërballueshëm ndërsa 8.8% mendojnë se çmimi është i ultë.

Nëse përdorni shporta të përbashkëta të lagjes, a është i përshtatshëm lokacioni ku janë të vendosura shportat?



47.5% e respondentëve janë përgjigjur se lokacioni ku janë vendosur shportat e lagjes, nuk është i përshtatshëm ndërsa 43.5% mendojnë se lokacioni është i përshtatshëm.

Nëse ndarja sipas llojit të mbeturinave kërkohet nga ju, a do ta bënit këtë?



Nëse ndarja e mbeturinave sipas llojit kërkohet nga ju, 97.1% janë përgjigjur se do të bënin, ndërsa 2.9% janë përgjigjur se nuk do ta bënin.

Në rastet kur në familjen tuaj krijohen mbeturinat nga ndërtimi dhe demolimi (apo të vëllimshme, mobilje etj.), ku e bëni deponimin e tyre?




Në rastet kur në familjet e tyre krijohen mbeturina nga ndërtim demolimi apo të vëllimshme, 29.5% janë përgjigjur se ato i deponojnë në lokacionin e përcaktuar nga komuna. 23.9% janë përgjigjur se ato i vendosin në afërsi të shportës së familjes apo lagjes. 21.2% e njoftojnë kompaninë grumbulluese dhe i merr ajo, ndërsa 12.9% janë përgjigjur se ato i vendosin në gropa apo kudo që gjejmë hapësira të pashfrytëzuara.

Në këtë pyetje, respondentët kanë pasur mundësinë të japin përgjigje edhe nëpërmjet deklaramit. Disa prej komenteve në këtë pyetje janë si vijon:


- *“Në vendet që kanë hedh mbeturinat dhe materialet ndertimore, të na mas shkolles i gjun e ka edhe vene tjera plot valla”*
- *“Kerkojm alternativa tjera sepse lokacioni i përcaktuar nga komuna nuk është i përshtatshëm”*
- *“Qikjo pyetje shume me vend, mbetjet inerte krejt fshatrat e malisheves dhe thuajse te krejt kosoves i gjuajnë ne periferi te fshatit, është bere krejt berllog, tana anet, kah te kthej koken krejt berllog”*
- *Deponojme ne hapësira te shtëpisë, apo dergojme vete ne kompanite grumbulluese, sepse edhe krahas lajmrrimit nuk kane ofruar kete shërbim”*
- *“Angazhojme transportuesit private dhe nuk kemi me përgjegjesi”*

A ka deponi ilegale (grumbuj të mbeturinave) në hapësira publike në vendbanimin tuaj?




Për deponitë ilegale nëpër hapësira publike, 46.5% janë përgjigjur se ka pak deponi ilegale. 36.3% janë deklaruar se po, ka shumë deponi ilegale, ndërsa 17.3% kanë thënë se jo, nuk ka fare deponi ilegale.

A dini se ku përfundojnë mbeturinat pasi të grumbullohen nga ju?



Lidhur me përfundimin e mbeturinave, pasi grumbullohen nga ta, 56% janë deklaruar se e dinë ku përfundojnë mbeturinat, ndërsa 44% janë përgjigjur se jo, nuk kanë ide ku përfundojnë ato.

A jeni të shqetësuar për metodat e hedhjes së mbeturinave pas grumbullimit?



87% e respondentëve janë të shqetësuar për metodat e hedhjes së mbeturinave pas grumbullimit, ndërsa 13% janë deklaruar se nuk janë të shqetësuar.

Në fund të pyetësorit, ka qenë e parashtruar pyetja:

Nëse keni ndonjë koment apo sugjerim lidhur me menaxhimin e mbeturinave dhe mjedisin në përgjithësi, mund ta paraqisni këtu:

Lidhur me këtë pyetje, janë dhënë shumë përgjigje të ndryshme, disa nga më përfaqësueset e të gjithë respondentëve, janë si më poshtë:

“Mendoj se duhet te praktikohet gjoha ndaj atyre qe hudhin mbeturina edhe pse egziston si rregull momunale kjo kurr nuk praktikohet dhe pupulli yne apo une vet nuk vetedijesohem pa u gjobitur. Ne mirembajm hapsirat tona private por ato jashte deres dhe ato publike mund te hudhim, mund te peshtym ne toke etj. Une ka vite se organizoj akcione per pastrim dhe vetedijesim por kot eshte. DUHET GJOBITUR”

“Verejtja ime kryesore eshte se aty ku komuna ime Istogui hedhe mbeturinat eshte duke i tymosur ngulfatur me shum se 6 ,7 fshatra per rreth per arsye qe deponis ia vejne flaken ose kompanija ose komunja kto te dyja i kan te gjitha fajete per nje ambijent te pa paster ne fshatrat tona!!”

“Mendoj se shteti merret fare pak me menagjimin e mbeturinave, kompanive per kryerjen e sherbimit dhe te deponive. Duhet te investohet me shume ne furnizim me mjete me moderne per grumbullimin e mbeturinave dhe mirmbajtja me e mire e deponive, me qe kam pas rastin me i pa ato. Ne pergjithsi qeveri, komunitat duhet te investojne me shume ne kete fushe.”

“Duhet filluar urgjentisht me ndarjen /klasifikimin e mbeturinave me qëllim të minimizimit të tyre dhe riciklimit”

“Ne qytetin e Ferizajit problemi i mbeturinave eshte nje porblem shume i madh sepse kompania pergjegjese nuk e kryne punen e tyre as per se afermi. Çdo dite neper qytet por edhe neper lagje shef mbeturina te pa pastruara nga kompania. Ne vendet ku ka disa kontinjer mund te shohesh kaosin me mbeturina sepse kompania nuk i mbledh me kohe edhe ne mynere te rregullt. Per mendimin tim situata ne qytetin e Ferizajit eshte pothuajse jashte kontrollit, sa i perket pastrimit nga mbeturinat.”

“Te kete shporta te vogla ne qytet. Poashtu ne konteniera te kete hapësire per ndarje te mbeturinave /leter, plastike, elektronike, veshmbathje etj.”

...

PËRFUNDIMET

- ≡ Gjetjet aktuale nxjerrin në pah se Ligji për mbeturinat ofron kornizë të mjaftueshme për strukturimin e sistemit të menaxhimit të mbeturinave në Kosovë. Kompetencat dhe dokumentet kryesore për planifikim dhe organizim të menaxhimit të mbeturinave janë të përcaktuara qartë. Megjithatë, mungon zbatimi i disa prej kërkesave ligjore.
Gjetjet tregojnë se Strategjia e Republikës së Kosovës për menaxhimin e mbeturinave është hartuar vitin e kaluar, por mungon Plani i Republikës për menaxhimin e mbeturinave. Në anën tjetër, 87% e komunave kanë hartuar Planet komunale të menaxhimit të mbeturinave, por janë 20 komuna të cilat aktualisht nuk kanë periudhë të vlefshme të zbatimit, që nënkupton se këto komuna menaxhojnë mbeturinat pa bazë planifikimi. Janë edhe 6 komuna tjera të cilave iu përfundon periudha e zbatimit të Planit në vitin 2022. Për Planet komunale të cilat kanë përfunduar, nuk ekzistojnë raporte të vlerësimit apo të zbatueshmërisë dhe realisht nuk dihen efektet që kanë pasur këto Plane në sistemin e menaxhimit të mbeturinave nëpër komuna.
- ≡ Në anën tjetër, edhe pse gradualisht, mbulueshmëria e ekonomive familjare me shërbim të grumbullimit të mbeturinave është në rritje, aktualisht 85.2% në nivel vendi. Me rritjen e mbulueshmërisë me shërbim, deponitë ilegale kanë pësuar rënie. Vetëm në vitin 2021, janë identifikuar gjithsej 1188 deponi ilegale, ku prej tyre 558 janë të mëdha – gjendje e cila vazhdon të mbetet problematike. Përrjashtimisht nga viti i fundit, trendi i sasisë së mbeturinave që deponohen në deponi sanitare, është në rritje. Rritja e vazhdueshme e mbeturinave të deponuara nënkupton se në Kosovë ofrohet vetëm shërbimi bazik i menaxhimit të mbeturinave – grumbullim. Megjithëse vetëm rreth 5% e ekonomive familjare kanë qasje në infrastrukturë për ndarje të mbeturinave në burim nuk ka sistem të përcaktuar mirë të grumbullimit të ndarë të mbeturinave, riciklimit apo nisma në ekonomisë qarkore.
- ≡ Nga këndvështrimi i qytetarëve, gjetjet tregojnë se 86.3% e respondentëve mendojnë se keq-menaxhimi i mbeturinave është një prej problemeve mjedisore në Kosovë dhe 43.3% e tyre mendojnë se efektet në shëndetin e njeriut është shqetësimi më i madh që vjen nga mbeturinat.
Në shërbimin aktual për 47.5% të respondentëve, mbeturinat përreth shportave, janë problemi që i pengon më së shumti në sistemin e menaxhimit të mbeturinave. 81.7% e tyre mendojnë se tarifa e shërbimit është e përshtatshme – çmim mesatar. 47.5% e respondentëve të cilët përdorin shërbim kolektiv, mendojnë se lokacioni i vendosjes së shportave nuk është i përshtatshëm. Ndërsa, 97.1% e respondentëve deklarohen se nëse ndarja e mbeturinave në burim kërkohet nga ta, do ta bëjnë atë.
Lidhur me sistemin e menaxhimit të mbeturinave, 56.6% e respondentëve janë mesatarisht të kënaqur me shërbimin aktual të menaxhimit të mbeturinave. 77.5% e tyre mendojnë se autoritetet kompetente nuk po punojnë mjaftueshëm për menaxhimin e mbeturinave.

REKOMANDIMET

- ≡ Në mungesë të planit të republikës së Kosovës për menaxhimin e mbeturinave, komunat janë të detyruara që planet komunale t'i harmonizojnë me Strategjinë kombëtare për menaxhim të mbeturinave, e cila paraqet nivel më të lartë të planifikimit. Andaj, në mënyrë që komunat t'i harmonizojnë planet lokale me të, Ministria duhet të hartojë Planin e republikës së Kosovës për menaxhimin e mbeturinave.
- ≡ Në vitin 2022, bëhen 26 komuna të cilat nuk kanë plane komunale të menaxhimit të mbeturinave. Komunat duhet të nxjerrin raporte mbi nivelin e zbatueshmërisë së planeve dhe efekteve të zbatimit të tyre në terren. Në të njëjtën kohë, të skanohet gjendja reale ekzistuese në terren dhe të merret për bazë gjatë hartimit të Planeve për periudhën e re të zbatimit.
- ≡ Të vazhdohet rritja e shkallës së mbulueshmërisë me shërbime bazike në 100% në mënyrë që të adresohet gjendja me deponitë ilegale.
- ≡ Plani i republikës së Kosovës, dhe planet e reja komunale të menaxhimit të mbeturinave të orientohen në ekonominë qarkore – në reduktim, ndarje në burim, ripërdorim e riciklim, në mënyrë që të zvogëlohet sasia e mbeturinave që deponohet në deponitë qendrore.

BURIMET

- ≡ Ligji Nr. 04/L-060 për mbeturina;
- ≡ Ligji Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale;
- ≡ Raporti i Progresit i Komisionit Evropian për Kosovën (viti i publikimit: 2021);
- ≡ Strategjia e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave;
- ≡ Raporti menaxhimit të mbeturinave komunale në Kosovë – AMMK 2020;
- ≡ Planet Komunale të menaxhimit të mbeturinave;
- ≡ Rregulloret Komunale për menaxhimin e mbeturinave;
- ≡ Ueb faqet e komunave;
- ≡ Gjetjet nga pyetësori online;